

## Kush do të përfitojë nga ky projekt?

Përfituesit e këtij projekti janë i gjithë komuniteti i rrethit Kurbin por edhe i rretheve përfaqësi nëse ne arrijmë të sigurojmë bashkëpunimin e pushtetit vendor për ta futur në planet më të afërta të buxhetit të Bashkisë, atëherë të gjithë përfitojmë. Përfituesit janë tregtarët, konsumatorët dhe Bashkia Kurbin pasi Pazarit i Milotit është një vlerë autentike e zonës, burim të ardhurash ekonomike, gjithashtu edhe një mënyrë socializimi dhe aktiviteti për banorët e Kurbin, sidomos për gratë duke qënë se qyteti i Milotit nuk ofron shumë mundësi të aktiviteteve për socializim dhe argëtim. Do të rritet siguria dhe cilësia e produkteve të tregtuara në këtë treg, kapaciteti dhe numri i tregtarëve. Nevoja më e madhe e komunitetit është që zëri ynë të dëgjohet dhe të llobojmë për zgjidhjen e një problemi të tillë që ne na prek të gjithëve!

Bashkohuni në aktivitetet tona. Ne do të jemi çdo të dielë me standën tonë në pazarin e Milotit. Jeni të ftuar në takimet tona që do bëjmë të gjithë bashkë me Bashkinë e Kurbin ku ju mund të shprehni problematikën, nevojat dhe kërkesat tuaja në lidhje me Pazarin e Milotit.




## Rikonceptimi i Pazarit të Ri të Milotit



Partner nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Restrukturim SOC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Restrukturim SOC

[pazarimilotit@gmail.com](mailto:pazarimilotit@gmail.com)

Pazarit i Ri Milot

Ne jemi një grup të rinjsh nga rrethi i Kurbinit të cilët kemi marrë një iniciativë së bashku me Leviz Albania për të ngritur një kauzë shumë thelbësore për qytetin e Milotit:

**- Rikonceptimi dhe ndërtimi i Pazarit të ri të Milotit, përmirësimi i menjëhershëm i kushteve higjeno-sanitare, garantimi i sigurisë dhe cilësisë ushqimore, rritja e kapacitetit të tregut dhe përmirësimi i kushteve të punës.**

Kjo është prej kohësh një nga problemet më emergjente të zonës tonë të Kurbinit dhe jemi pikërisht ne komuniteti që nuk duhet të lejojmë më të vazhdojmë në këtë gjëndje!

Të gjithë së bashku duhet të ngrihemi njëzëri dhe të llobojmë për rindërtimin e pazarit të ri të Milotit në kushte më të mira që të ofrojnë sigurinë ushqimore, kushte të favorshme për tregtarët, formalitet ekonomik dhe të jetë shembull i nje tregu të mirëfilltë duke qënë se

***Pazari i Milotit është një ndër burimet kryesore ekonomike për qytetarët e rrethit Kurbin.***



## **Miloti e meriton një Pazar të Ri dhe të Denjë!**

***Bashkohuni në kauzën tonë të përbashkët!***

***Të gjithë së bashku mund t'ja arrijmë!***

***Ju stojmë të na ndiqni në faqen tonë***

***facebook "Pazari i Ri Milot" ku do t'ju***

***mbajmë të informuar për aktivitetet tona***

***në vazhdim.***

**Nën hashtagun #njepazariripermilotin# mund të tregojmë të gjithë solidaritetin tonë përkundrejt kësaj kauze.**

